



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilimjen/Prodato Received/Delivered	18 - 05 - 2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKSHUK	2908/2022		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.323/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.323/2022 të datës 04.04.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] përmes Postës së Kosovës me numër R 2180822 me vulë postare me datë 31.03.2022, me adresë banimi:

[redacted] kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "kundër anulimit të konkursit" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 18.05.2022, mori këtë:

### V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.323/2022 e datës 04.04.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

### A r s y e t i m

Ministria e Drejtësisë /Shërbimi Korrektues i Kosovës fillimisht me datën 08.11.2021 ka njoftuar me konkursin, ndërsa me datën 23.11.2021 ka shpallur konkursin e brendshëm me numër reference RN00007760, „Lëvizje brenda kategorisë“ për vendin e punës "Zyrtar i Lartë për Trajtimin e të Burgosurve dhe të Miturve si dhe Çështje Sociale".

Ankuesi [redacted], i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK), në pozitën "Zyrtar i Shërbimeve Sociale", në Njësinë e Shërbimeve Sociale, sipas shkresave të lëndës ka aplikuar në konkursin e shpallur te datës 23.11.2021 dhe e njëjti i ka plotësuar kushtet ligjore për të marrë pjesë në intervistë me gojë sipas procedurës për lëvizje brenda kategorisë. Ankuesi me datë 28.12.2021 është njoftuar se nga intervista me gojë është vlerësuar me gjithsej 70.4 pikë.





Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 05.01.2022 ka nxjerrë Vendim numër protokollit 0004, për anulimin e procedurës së rekrutimit për pozitën: *'Zyrtar i Lartë për Trajtimin e të Burgosurve dhe të Miturve si dhe Çështje Sociale'*, me numër reference RN00007760, me arsyetim se *'janë në hartim të rregullores për organizimin e brendshëm deri në miratimin e kësaj rregullore konkursi i shpallur anulohet'*, për të cilin vendim ankuesi është njoftuar në e-mailin zyrtar të dërguar përmes sistemit elektronik SIMBNJ-së.

Ankuesi, kundër anulimit të procedurës së rekrutimit për pozitën: *"Zyrtar i Lartë për Trajtimin e të Burgosurve dhe të Miturve si dhe Çështje Sociale"*, me datë 31.03.2022 përmes emailit zyrtar ka parashtruar ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Ankuesi kundër anulimit të procedurës së rekrutimit për pozitën: *"Zyrtar i Lartë për Trajtimin e të Burgosurve dhe të Miturve si dhe Çështje Sociale"*, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Postës së Kosovës me numër R 2180822 të vulosur me datë 31.03.2022, e cila është pranuar në me datë 04.04.2022 me numër protokollit 1804/2022, duke pretenduar se anulimi ka qene i kundërligjshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 08.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa me datë 20.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë përmes formës elektronike E-mailit të datës 20.04.2022 me nr. protokollit 2240/2022, ndaj të cilës është kërkuar prova shtesë me datë 17.05.2022, për shkak mungesës së provave të cilat janë bashkangjitur me datë 17.05.2022 dhe me datës 18.05.2022, të bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën ankesën me numër të protokollit 1804/2022 të regjistruar me numër A.nr.323/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; përmes Postës së Kosovës me numër R 2180822 të vulosur me datë 31.03.2022-Pliko; Përgjigje ne ankesë e datës 17.052022 dhe 18.05.2022; .02.20iiko, e cila është pranuar në me datë 04.04.2022; Konkursi i datës 08.11.2021; Kartela identifikuese e MPB; Njoftimi i datës 03.12.2021; Njoftimi i datës 10.12.2021; Vendimi i datës 05.01.2022; Rezultatet e verifikimit paraprak e nxjerr nga SIMBNJ-së; Përgjigje e datës 20.04.2022 në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Prova shtesë E-mail i datës 17.05.2022 dhe datës 18.05.2022 ; Lista e aplikacionit e nxjerr nga SIMBNJ dhe lista e kandidateve të aprovuar; Aplikacioni i ankuesit CV-së; Aplikacioni i z.N.R me CV-së, Dosja e kandidatit N.R, Akt emërimi i datës 21.05.2012, Diplome Nr.1230 e ditës 18.03.2019 nga masterit, me titullin - Master i Pedagogjisë, Diplomë nga studimet themelore të datës 30.09.2010 Bachelori i Pedagogjisë, Vërtetim i datës 10.12.2021; certifikata; Vërtetim i datës 09.07.2015, Formulari i vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2020; Aplikacioni i z.T.H. me CV, Dosja e kandidatit T.H, Akt emërimi i datës 26.03.2013, Diplome Nr.133 e ditës 15.11.2002 nga studimet themelore me titullin - Profesor i Filozofisë -Sociologjisë; Konfirmim për master/diplomë e datës 19.10.2021; Kolegji AAB-së; certifikata; Aplikacioni i z.Sh.S. me CV, Dosja e kandidatit SH.S, Akt emërimi i datës 01.12.2012, Certifikata; Diplome Nr.1230 e ditës 18.03.2019 nga studimet e masterit, me titullin - Master i Pedagogjisë, Diplomë nga studimet themelore të datës 30.09.2010 Bachelori i Pedagogjisë; Aplikacioni i z.I.U. vërtetim i datës 23.09.2016;Referencë e datës 25.05.2021; Diplome Nr.4860 ditës 11.10.2016 nga studimet



themelore me titullin - Profesor i Punës Sociale; Kontratë për praktik e datë 31.05.2016; Formulari i vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2019; Formulari i vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2020; Vërtetim i datë 10.06.2017; Vendimi i datës 02.12.2021 për kandidatin që nuk i plotëson kriteret e konkursit SH.S; Vendimi i datës 02.12.2021 për kandidatin që nuk i plotëson kriteret e konkursit z.N.R; Ankesë e datë 06.12.2021 nga R.H; Vendimi i datës 10.12.2021 për kandidatin që i plotëson kriteret e konkursit N.R; Kopje e nxjerrë nga sistemi SIMBNJ-së për anulim të procedurës për mes sistemit, ku dhe njoftohen nëpunësit në e-mail zyrtar; Vendimi i datë 0.12.2021 për emërimin e komisionit përzgjedhës për procedurën e rekrutimit; Kërkesë për fillimin të rekrutimit i datë 08.10.2021; Kërkesa për aprovim të buxhetit e datë 15.10.2021; Njoftim i datës 15.05.2012; Email i datë 18.05.2021, lidhur me njoftimin e dërguar tek kandidatet përmes sistemit SIMBNJ-së, lidhur me anulimin e konkursit të datës 05.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është e  
*palejuar sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm me datë 05.01.2022 ka nxjerrë Vendimin numër protokoli 0004, për anulimin e procedurës së rekrutimit për pozitën: *"Zyrtar i Lartë për Trajtimin e të Burgosurve dhe të Miturve si dhe Çështje Sociale"*, me numër reference RN00007760, për të cilin vendim ankuesi është njoftuar përmes sistemit elektronik SIMBNJ-së, në forme automatike siç e dëshmon dhe prova e Njësisë së Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës duke bashkangjitur në provat e lëndës formularin e sistemit të datës 05.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, konstaton se, që nga koha kur është nxjerrë Vendimi me numër protokoli 0004, i datë s 05.01.2022 i Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimit Korrektues të Kosovës për anulimin e procedurës së rekrutimit për pozitën: *"Zyrtar i Lartë për Trajtimin e të Burgosurve dhe të Miturve si dhe Çështje Sociale"*, me numër reference RN00007760, deri tek data 31.03.2022 kur ankuesi për mes Postes së Kosovës e ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me numër protokoli 1804/2022 me datë 04.04.2022, kanë kaluar të gjitha afatet ligjore të përcaktuara në nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se ***"1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"***, ndërsa sipas nenit 51 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: ***1. Një akt administrativ fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cenohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij"***, si rrjedhojë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 04.04.2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 125 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se ***1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative)" te parapare sipas nenit 127 paragrafi 4 të këtij ligji***, andaj, mbi këto baza ligjore të specifikuar më lartë, ankesa



e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji", në këtë rast ankesa e ankuesit është parashtruar jashtë afatit ligjor sipas dispozitave të lartë cekura.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.323/2022**

Zyle Milaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së